

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Njëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë njëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Korrik, 2021


Konferenca e Nivelit të Lartë mbi “Sfidat dhe mundësitë në luftën kundër korrupsionit dhe në forcimin e integritetit”

05.07.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, organizoi konferencën e nivelit të lartë mbi “Sfidat dhe mundësitë në luftën kundër korrupsionit dhe në forcimin e integritetit”. Punimet e konferencës u zhvilluan në dy panele me tematikë (1) “Sfidat dhe mundësitë në qasjen ndëshkuese ndaj korrupsionit” dhe (2) “Sfidat dhe mundësitë në parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit”. Në diskutimet e Panelit 1, fokusi u vendos në rëndësinë e ndëshkimit të rasteve të korrupsionit dhe u kërkua intensifikimi i ndërhyrjeve nga institucionet ligjzbatuese. Paneli 1 u drejtua nga Ministria e Drejtësisë, Znj. Etilda Gjonaj, me pjesëmarrjen e drejtuesve të SPAK, Z. Arben Kraja dhe BKH, Znj. Aida Hajnaj, të Ambasadorit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Z. Luigi Soreca dhe të Këshilltarit Ligjor të Përhershëm të Departamentit të Drejtësisë në Ambasadën e SHBA-së, Z. Clay Stiffler. Paneli 1 pati të ftuar të veçantë, Prokurorin Drejtues të Divizionit Kombëtar Rumun Antikorrupsion, Z. Crin Bologa, që solli të dhëna të veprimtarisë së prokurorisë antikorrupsion në Rumani. Paneli 2 u drejtua nga Zëvendësministria e Drejtësisë, Znj. Adea Pirdeni, me pjesëmarrjen e Ambasadorit të Italisë në Shqipëri, Z. Fabrizio Bucci, Sekretares Ekzekutive të GRECO, Znj. Hane Juncher si dhe Drejtueses së Sekretariatit të RAI, Znj. Desislava Gotskova, të cilët sollën eksperiencën e organizatave që drejtojnë dhe shprehën mbështetjen e tyre si partnerë strategjikë të Shqipërisë për forcimin e mëtejshëm të luftës kundër korrupsionit.



Vijojnë punimet e Grupit të Punës për vlerësimin dhe ngritjen e Zyrës Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve

14.07.2021. Grupi i Punës për krijimin e Zyrës Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve (ZRA), i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 49, datë 28.05.2021, vijoi takimet gjatë muajit Korrik, përkatësisht në datat 14, 16 dhe 30. Fokusi i këtyre takimeve ishte analiza e kuadrit ligjor ekzistues, vlerësimi i nevojës për ndryshime të mundshme ligjore, si edhe vlerësimi i ngritjes dhe organizimit të strukturës së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në lidhje me varësinë funksionale, financiare dhe fushën e kompetencës. Në konsideratë janë marrë disa modele evropiane të organizimit dhe funksionit të institucioneve të rikuperimit të asetëve, si edhe propozime konkrete nga të ftuar të ndryshëm. Në mbledhjen e datës 30 Korrik, u prezantuan tre modele të atashimit të ZRA-së pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pranë Policisë së Shtetit, si edhe u diskutuan avantazhet dhe disavantazhet e secilit model. Anëtarët e grupit të punës, në përfundim të punimeve do të dakordësojnë modelin më të përshtatshëm për Shqipërinë. Vendimmarrja do të jetë pjesë e një diskutimi të hapur me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të fushës, si edhe aktorë të shoqërisë civile. Ngritja e kësaj zyre është në përputhje me masat e parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit, si edhe në përmbushje të rekomandimeve të raporteve të Komisionit Evropian.




Monitorimi dhe hartimi i Draft-Raportit Gjashtëmujor të Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

01.07.2021. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka filluar procesin e monitorimit dhe hartimin e draft-raportit gjashtëmujor të monitorimit të Planit të Veprimit, 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën Janar-Qershor 2021. Monitorimi po kryhet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet zbatuese të Planit të Veprimit, në përputhje me planifikimet e bëra në këtë plan. Draft-raporti i monitorimit synon të paraqesë në mënyrë përmbajtësore dhe sasiore progresin e bërë nga të gjitha institucionet raportuese për zbatimin e masave/aktiviteteve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, nivelin e realizimit të indikatorëve, si edhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e kaluar. Ky është raporti i dytë i monitorimit për vitin 2021, i Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Draft-Raporti gjashtëmujor do të nënshtrohet periudhës së konsultimit institucional me të gjitha institucionet raportuese si edhe konsultimit me publikun dhe OSHC-të.



Hartimi dhe konsultimi publik i Draft-Instrumentit Metodologjik të Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore

07.07.2021. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit 2020-2022 të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (OGP), konkretisht me pikën e referimit nr.9, masën prioritare nr. 2, angazhimin nr.1 të komponentit tematik antikorrupsion, hartoi Draft-Instrumentin Metodologjik të Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore. Ky dokument do t'i shërbejë Ministrisë së Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të Planit të saj institucional të Integritetit, si edhe i paraprin nevojës për monitorim të institucioneve të tjera qendrore, të cilat janë në procesin e hartimit të Planeve të tyre institucionale të Integritetit. Dokumenti iu nënshtrohet procesit të konsultimit publik në përputhje me parimin e bashkë-bërjes së dokumenteve të politikave me organizata aktive të Shoqërisë Civile në vend. Pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, u organizua edhe një takim i dedikuar konsultativ me OSHC-të, komentet dhe sugjerimet e të cilave u reflektuan plotësisht në dokument.



Cikli i trajnimeve me pikat e kontaktit antikorrupsion

06.07.2021. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe ASPA, përfundoi pjesën e parë të ciklit të trajnimeve për pikat e kontaktit antikorrupsion. Objektivi kryesor i këtij cikli trajnimesh ishte forcimi i kapaciteteve për pikat e kontaktit antikorrupsion në organet e administratës publike. Përgjatë pjesës së parë të këtij cikli, Qershor-Korrik, pikat e kontaktit antikorrupsion u trajnuan lidhur me çështje të parandalimit dhe praktikave më të mira antikorrupsion, modelet e koordinimit dhe përshkrimet e punës të pikave të kontaktit antikorrupsion, planifikimi dhe monitorimi i strategjive antikorrupsion dhe planeve të veprimit, hartimi dhe zhvillimi i treguesve të performancës dhe ndikimit, si edhe etika dhe integriteti i nëpunësit civil. Pjesa e dytë e ciklit të trajnimeve do të vijojë në muajin Shtator 2021.



Workshop-i prezantues i Analizës së Koordinimit të Politikave në Shqipëri

15-16.07.2021. Drejtues të Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve në Fushën e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, morën pjesë në seminarin e organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike, mbi procesin e Analizës së Koordinimit të Politikave në Shqipëri. Ky aktivitet u zhvillua në vijim të publikimit të studimit “Koordinimi i Politikave në Ballkanin Perëndimor”. Synimi kryesor i këtij aktiviteti ishte prezantimi i gjetjeve të analizës si edhe rekomandimeve për adresimin e problematikave të konstatuara në rajon në përgjithësi dhe në Shqipëri në veçanti, për implementimin efiçent dhe koordinimin efiçent midis politikave strategjike në vend. Në aktivitet u trajtuan çështje si: zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional për koordinimin e politikave, vlerësimi i rolit të institucioneve ndërkombëtare në koordinimin e politikave në Shqipëri, koordinimi i strategjive PAR dhe PFM me strategjitë e fushës, përfrimi i planifikimit të politikave me planifikimin buxhetor, koordinimi i institucioneve qendrore, rekomandimet për përmirësimin e mekanizmit të koordinimit të politikave, si edhe forcimi i planifikimit strategjik bazuar në të dhëna faktike. Seminari kontribuoi në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknike e profesionale të stafit të Programeve në Fushën Antikorrupsion, aty ku krijohen, koordinohen dhe konsolidohen planifikimi i politikave dhe dokumenteve të veprimit të fushës antikorrupsion.

